



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23.1.2025

Nr: 30

Ora:

VENDIM

PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE DAKTILOSKOPIKE TË MBLEDHURA NGA
PAJISJET E IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR
KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të nenit 14, pika 2, nenit 19, pikat 1, shkronja “a”, dhe nenit 167/2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

VENDOSIM:

1. Procesi i verifikimit të të dhënave daktiloskopike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024, bëhet nga administrata e KQZ-së për identifikimin e rasteve të dyshuara të votuesve të shumëfishtë.
2. Në përfundim të verifikimit hartohet raporti paraprak, të cilin Sekretari i Përgjithshëm ia paraqet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
3. Raporti paraprak i dërgohet për njohje subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në procesin e këqyrjes, të cilat brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh mund të parashtrajnë komentet e tyre.
4. Raporti përfundimtar për këqyrjen e të dhënave PEI miratohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
5. Personeli i ngarkuar për këqyrjen ruan konfidencialitetin e të dhënave në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
6. Personeli i ngarkuar për këqyrjen ndalohet të kopjojë, fotoqjojë, përpunojë, statistikojë, indeksojë të dhënat personale gjatë ushtrimit të detyrës.
7. Ngarkohet administrata e KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI